



Bashkia Shkodër



QENDRA AURA

Nr. 10945 Prot

Shkodër, më 05.07, 2022

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

“Për bashkëpunimin në ofrimin e ekspertizës në edukimin ligjor të publikut, demokratizimit të shoqërisë, njohjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut”

Sot, më datë 05/07/2022 lidhet kjo Marrëveshje Bashkëpunimi (“Marrëveshje”) midis palëve të mëposhtme:

Bashkia Shkodër, me adresë: Rruga '13 Dhjetori' Shkodër - Shqipëri, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Shkodër, Z. Bardh Spahia, këtej e tutje cilësuar si Bashkia,

dhe

Qendra AURA, me adresë “Rruga Janoush Hunyadi, ”Pallati Domus Group, Kt 2, Tiranë - Shqipëri, përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv, Znj. Enkeledi Hajro, këtej e tutje cilësuar si Qendra AURA;

Baza Ligjore

ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar

ligjinr.7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar

ligji nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse” të ndryshuar

Individualisht referuar në këtë Marrëveshje si “Pala”, dhe bashkërisht si “Palët”.

Palët në këtë marrëveshje bashkëpunimi bien dakord për nënshkrimin e saj si më poshtë:

NENI 1

Qëllimi

Kjo Marrëveshje ka për qëllim vendosjen e marrëdhënieve institucionale midis Qendrës AURA dhe Bashkisë Shkodër në kuadër të bashkëpunimit për edukimin ligjor të publikut, demokratizimit të shoqërisë dhe njohjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut me fokus njohjen dhe aplikimin e standardeve më të mira në qeverisjen demokratike, edukimin dhe pjesëmarrjen e publikut në politik-bërjen lokale, aktivizimi qytetar dhe edukimi ligjor i të

rinjve ndërmjet kurrikulave shkollore për krijimin e një mjedisi sa më të mirë në të gjitha aspektet ligjore, sociale, kulturore e arsimore, mbrojtjen e minoriteteve, zhvillimin e dialogut dhe bashkëpunimit ndërmjet grupeve sociale të ndryshme në frymën e tolerancës, duke eliminuar diferencat ndërmjet tyre dhe pranimin e personave të ndryshëm, të huaj, emigrantë që bëhen pjesë e shoqërisë shqiptare, duke edukuar shoqërinë me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe promovimin e ndërmjetësimit si mjet zgjidhje ligjore për mosmarrëveshjet ndërmjet të rinjve, personave apo grupeve të ndryshme.

NENI 2

Objekti i Marrëveshjes

Objekt i kësaj Marrëveshje është përcaktimi i roleve dhe përgjegjësi të ndërsjellta që lidhen ekskluzivisht me përmbushjen e qëllimit të kësaj marrëveshje.

NENI 3

Kohëzgjatja

Kjo marreveshje bashkëpunimi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga palët dhe është e vlefshme deri 31/12/2022

NENI 4

Gjuha e marrëveshjes

Gjuha e kësaj marrëveshje bashkëpunimi është gjuha shqipe

NENI 5

Përgjegjësitë e Palëve

Secila palë do të kontribuojë në zbatimin e kësaj Marrëveshje si vijon: Qendra AURA në cilësinë e ofruesit të shërbimeve, ekspertizës dhe asistencës së saj dhe Bashkia Shkodër në cilësinë e marrësit të këtyre shërbimeve, nga ku rrjedhin edhe detyrimet thelbësore të Palëve:

Qendra AURA:

- a. Qendra AURA, bazuar në misionin e saj dhe qëllimin për të cilin është themeluar, ofron shërbimet e saj për publikun shkodran.
- b. Qendra AURA do të ofrojë ekspertizën e saj lidhur me hartimin e nismave ligjore, informacionin e nevojshëm për edukimin e publikut nëpërmjet komunikimeve në terren, në rrugë elektronike, me anë të fletëpalosjeve dhe takimeve me grupe të ndryshme, vënien në dispozicion të autoriteteve të bashkisë, të dokumenteve të hartuara me gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet lidhur me çështje të rëndësishme që prekin qeverisjen lokale dhe vendimmarrjen e nevojshme mbi propozimet që kanë ardhur nga pjesëmarrja e publikut në veprimtaritë e organizuara.
- c. Qendra AURA merr përsipër të mbështesë Bashkinë Shkodër në implementimin e iniciativave të nevojshme që përfshihen brenda fushës së saj të veprimit.
- d. Qendra AURA do të mbështesë Bashkinë për fushatën e ndërgjegjësimit të opinionit publik lokal në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrjen sa i takon çështjeve që prekin ata drejtpërdrejt.
- e. Qendra AURA do të ofrojë një Pikë Kontakti për koordinimin e veprimtarive të nevojshme në kuadër të implementimit të nismave që kanë të bëjnë me edukimin ligjor të publikut, demokratizimin e shoqërisë, njohjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut.

Bashkia Shkodër:

- a. Bashkia Shkodër merr përsipër sigurimin e lehtësirave të nevojshme teknike.
- b. Bashkia Shkodër merr përsipër të ofrojë pa pagesë mjediset, logjistikën dhe burimet njerëzore të kërkuara.
- c. Bashkia Shkodër merr përsipër të ofrojë informacionin e nevojshëm lidhur me çështje të rëndësishme që kërkojnë vëmendjen e publikut dhe pjesëmarrjen e tij me anë të propozimeve konkrete.
- d. Bashkia Shkodër do të ofrojë një Pikë Kontakti në koordinimin e gjithë punës së përbashkët.

NENI 6

Deklarimet dhe Garancitë

Palët deklarojnë dhe garantojnë sa më poshtë:

Palët kanë kompetencat dhe autoritetin e plotë për të lidhur këtë Marrëveshje.

Palët kanë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për autorizimin e lidhjes së kësaj Marrëveshje dhe për përmbushjen e detyrimeve të tyre.

Palët përgjigjen reciprokisht për përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të parashikuara në këtë Marrëveshje bashkëpunimi, për të punuar së bashku për realizimin me sukses të aktiviteteve të nevojshme.

NENI 7

Monitorimi, Vlerësimi dhe Raportimi

Palët (Bashkia Shkodër dhe Qendra AURA) do të ndajnë dhe informojnë periodikisht njëra-tjetrën mbi ecurinë dhe listën e aktiviteteve të parashikuara, dokumenteve të hartuara, pyetësorëve të realizuar, dhe rezultatet e përfutuara.

Në çdo rast punonjësit e angazhuar kanë detyrimin të mbrojnë konfidencialitetin në të dhënat në kuadër të Marrëveshjes.

NENI 8

Personat e Kontaktit

Secila nga palët përcakton një person kontakti të cilit/cilës i drejtohen të gjitha komunikimet, qofshin me gojë apo të shkruara, si elektronike ashtu dhe të shtypura në letër. Në çastin e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje personat e kontaktit janë si vijon:

Për Bashkinë Shkodër: Z. Bekim Mema

email: bekimmema@gmail.com / Tel. +355 69 43 66 588

Për Qendrën AURA: Znj. Enkeledi Hajro

email: auraforalbania@ngo-aura.al / Tel. +355 692055223

Në rast të ndryshimit të njërit prej këtyre personave, Pala e cila përfaqësohet prej këtij personi duhet të njoftojë me shkrim palën tjetër nënshkruese brenda një jave kalendarike për të dhënat e personit të ri të kontaktit.

NENI 9

Ndryshimi dhe Përfundimi

Palët mund të ndryshojnë ose të shtojnë në këtë Marrëveshje; çdo ndryshim apo shtesë në këtë

Marrëveshje bëhet vetëm me shkrim dhe nënshkruhet nga të dyja palët.

Secila nga palët mund të përfundojë këtë Marrëveshje në rastet kur:

- a. Shkelen dispozitat e ligjit dhe të Marrëveshjes;
- b. Palët nuk i përmbahen qëllimit dhe objektit të marrëveshjes;
- c. Për shkak të forcave madhore.

Për çdo rast, pavarësisht mënyrës së përfundimit, secila nga palët do të përmbushë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja deri në çastin e ndërprerjes së marrëdhënieve.

NENI 10

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve zgjidhen me frymën e mirëkuptimit dhe me bisedime ndërmjet tyre, në të kundërt kompetente do të jetë Gjykata rrethit gjyqësor Shkodër.

NENI 11

Dispozita të fundit

Palët janë të detyruara të respektojnë këtë Marrëveshje deri në momentin që ajo të përfundojë sipas mënyrave që parashikon neni 9.

Marrëveshja mund të ndryshohet apo amendohet vetëm nëpërmjet një dokumenti me shkrim të nënshkruar nga të dyja palët.

Kjo Marrëveshje bashkëpunimi përmban 4 faqe, dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët, si dhe hartohet në 4 (katër) kopje të barazvlefshme nga 2 (dy) kopje për secilën palë.

Palët përgjigjen reciprokisht për përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të parashikuara deri në fund të marrëdhënieve të kësaj Marrëveshje bashkëpunimi, për të qenë partnerë në zbatimin e saj duke punuar për realizimin e veprimtarive të përbashkëta.

Për
Bashkinë SHKODËR

KRYETARI
Bardh SPALLA



Për
Qendrën AURA

DREJTORI EKZEKUTIV
Enkeledi HAJRO

